



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:146848

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05422009

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.496/2019

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Xhemajl JUSUFI, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita DËRGUTI, në lëndën penale ndaj të pandehurit Sh...B.... për shkak të veprës penale: Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të Kodi Nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (tutje si: *KPRK*), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1288/2019, të datës 26.04.2019, të ri kualifikuar nga prokuroria, në veprën penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të Kodi Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tutje si: *KPRK*), pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 08.02.2024 në prezencën e Prokurorit të Shtetit, Arjan Xhema, i pandehuri Sh...B....., mbrojtësi i tij sipas autorizimit, avokat Vehbi Beqiri dhe përfaqësuesi i të dëmtuarës, V...L..., me datë 13.02.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 07.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

Sh...B...., me nofkën “Sh...”, nga i ati M..., e ëma M..., e vajzërisë A..., i lindur më datë 20.01.1977, në Mitrovicë, me vendbanim në fshatin K.. i M., Komuna e Mitrovicës, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Nga periudha e papërcaktuar deri me datën 06.07.2018, në shtëpinë e tij në fshatin K... i M..., Komuna e Mitrovicës, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar të KEDS, ka shfrytëzuar energjinë elektrike ashtu që nga njehsori i tij ka hequr një pllombë dhe i ka dëmtuar dy të tjerat dhe ka hapur njehsorin me të cilin ka manipuluar, në atë mënyrë që mos të tregoj shpenzimin e rrymës, që komisioni i KEDS-it ka vërtetuar në Qendrën e Kalibrimit, në bazë të shenjave të gërvishtjes në njehsor, kështu që palës së dëmtuar KEDS, i ka shkaktuar dëm në shumë prej 3,367.53 euro, që është vërtetuar nga ana e zyrtarëve të autorizuar të KEDS-it gjatë inspektimit ne terren.

Me këtë ka kryer veprën penale: Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 6 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 43, 69, 70 dhe 314 paragrafi 1 të KPRK-së dhe nenit 359, 360, 364, 449, 450, 452 dhe 462 të KPP-së, e:

G J Y K O N

- I. DËNIM ME GJOBË në shumë prej 500 euro (*me fjalë: pesëqind euro*), të cilin dënim është i obliguar që t' a paguaj në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjkata do të veprojë në bazë të nenit 43 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do t'i llogaritet me 20 (njëzetë)euro.
- II. Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë (20) euro, të gjitha këto në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- III. Obligohet i akuzuari t'ia kompensoj dëmin palës së dëmtuar KEDS në Mitrovicë, në shumë prej 3,367.53 euro (*me fjalë: tremijë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë euro, e pesëdhjetë e tre cent*), në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën/PP.II.nr.1288/2019 të datës 26.04.2019, kundër të pandehurit Sh...B.... për shkak të veprës penale: Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së. Ndërsa me parashtresën e datës 04.10.2019, prokuroria e ka ri kualifikuar në veprën penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së, duke qenë se ky ligj, i cili ka hyrë në fuqi nga data 14.04.2019 është më i favorshëm për të pandehurin në aspektin e dënueshmërisë, pasi që i njëjti, për dallim nga ai paraprak i cili parashihte në mënyrë kumulative dënimin me gjobë dhe burgim, ligji i ri e parasheh në mënyrë alternative me gjobë ose burgim.

Gjkata ka mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor me datë 16.01.2024, 05.02.2024, dhe 08.02.2024 në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurori i Shtetit Arjan Xhema, i pandehuri Sh...B....., mbrojtësi i tij sipas autorizimit, avokat Vehbi Beqiri, dhe përfaqësuesi i të dëmtuarës, V...L.... Në shqyrtim gjyqësor, i pandehuri është deklaruar i pafajshëm për veprën penale që i

vihej në barrë, ndërsa gjykata ka dëgjuar dëshmitarët, G... R..., F... M..., I... K.... dhe E.. H..., ka administruar provat materiale dhe është dhënë fjala përfundimtare e palëve.

Fjala përfundimtare e palëve

Në fjalën përfundimtare, prokurori i shtetit ka deklaruar se mbetet pranë aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.II.nr.1288/2019, të datës 25.04.2019 ndaj të pandehurit Sh...B...., duke përfshirë edhe precizimin e kësaj aktakuze të datës 03.09.2019 dhe propozimin se i pandehuri t'ia kompensoj dëmin në shumën e cekur në dispozitiv të aktakuzës të dëmtuarës KEDS, dhe pas administrimit të provave në mënyrë bindëse u vërtetua se i pandehuri e ka kryer veprën penale, edhe përkundër mohimit kategorik të tij se nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet me provat me të cilat u administruan veç e veç, përkatësisht Procesverbali me numër 724322, i datës 06.07.2018, nga foto dokumentacioni, dëshmitarëve përkatësisht inxhinierëve të cilët e kanë kontrolluar orën e cila ishte dorëzuar për kontroll, të njëjtit kanë konstatuar se në ore kishte pasur ndërhyrje, po ashtu edhe dëshmitari E... H.. detajisht e ka shpjeguar rastin se si kishte shkuar te i pandehuri, dhe ora kishte qenë pa pllombë e kishin fotografuar dhe kishin përpiluar procesverbal të cilin e kishte nënshkruar i pandehuri, nga të lartcekurat më lartë u vërtetu se jo vetëm është kryer vepra penale por edhe që kryerës i veprës penale është i pandehuri, andaj gjykatës i ka propozuar që të pandehurin ta shpall fajtor, ta dënoj sipas ligjit duke marrë parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës, V...L..., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: mbetet pranë deklarimeve të thëna në fjalën përfundimtare të Prokurorit të Shtetit, gjithashtu si palë e dëmtuar ka kërkuar nga gjykata që me rastin e administrimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, procesverbalin e hartuar nga ekipet e kontrollës ne teren. Procesverbalin e kalibrimit dhe foto dokumentacionin, të gjitha këto pasqyrojnë faktin se i pandehuri e ka kryer veprën penale, gjithashtu edhe nga deklarata e dëshmitarëve, dëshmitari E... H.. nga e ekipi i kontrollës kanë pasqyruar në mënyrë kronologjike të saktë situatën në ditën kritike, po ashtu edhe nga inxhinieret e qendrës që vërtetojnë faktin se njehsori në fjalë ka qenë i manipuluar dhe si rrjedhojë ka ardhur deri të dëmi i krijuar në raport me KEDS, vlerë kjo prej 3,367.53 euro, dhe ka kërkuar nga gjykata që të obligoj të pandehurin të kompensoj dëmin e shkaktuar kopanisë KEDS dhe të njëjtin ta shpall fajtor për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Mbrojtësi i të pandehurit Sh...B...., avokat Vehbi Beqiri, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: fjalën përfundimtare e dorëzon me shkrim në format A4, gjithsejtë tri faqe dhe të njëjtën e ka elaboruar, në të cilën ndër të tjera ka theksuar se nga seancat e mbajtura në këtë çështje penale, provat materiale, dëgjimi i dëshmitarëve nuk është vërtetuar se i pandehuri e ka kryer këtë vepër penale. Tutje, ka theksuar se i pandehuri gjatë deklaratës së tij të dhënë në Prokurori, ka dëshmuar se nuk ka ndërhyrë në njehsori elektrik dhe se nuk ka dijeni se si ka mundur të ndërhyj dhe kush ka ndërhyrë në të. Të gjitha këto prova materiale nuk kanë të bëjnë fare me të mbrojturin e tij andaj i ka propozuar gjykatës të merr aktgjykim me të cilin i mbrojturi i tij Sh...B.... të shpallet i pafajshëm lidhur me akuzën nga se nuk është provuar se ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

I pandehuri në fjalën përfundimtare ka deklaruar, se e mbështet fjalën e mbrojtësit dhe ka shtuar se sikur të kishte vetëm pak faj për këtë rast, do të ishte i gatshëm të pranoj fajësinë ose të gjente një zgjidhje, por ka theksuar se është plotësisht i pafajshëm dhe ka kërkuar nga gjykata që ta liroj nga akuza.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtura me datë 16.01.2024, 05.02.2024, dhe 08.02.2024, gjykata ka dëgjuar dëshmitarët G..R..., F...M..., I...K... dhe E...H....

Dëshmitari G..R..., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 11.01.2024, i cili mes të tjerash kishte deklaruar, se është punëtor i KEDS-it, si inxhinier në laborator. Tutje, nga prokurori i shtetit i janë prezantuar procesverbalet të datës 01.10.2018 i protokolluar me datë 02.10.2018, dhe ka theksuar se mbetet pranë tyre e po ashtu edhe fotografive të cilat janë realizuar ne teren dhe gjatë ekzaminimit të njehsorit, i cili njehsor është me numër serik 7054863, i vitit 1984, i cili është mekanik dhe nuk ka një softver në të cilin do të mund të ruheshin të dhënat e ndërhyrjes në të dhe në atë procesverbal është konstatuar vetëm ndërhyrjet por jo edhe kush ka ndërhyrë në të sepse nuk dihet shfrytëzuesi paraprak të njehsorit apo shifrën e tij por vetëm në bazë të numrit serik të tij. Më tej ka shtuar se pas ekzaminimit të njehsorit elektrik në fjalë dhe konstatimeve të gjetura te ky njehsor, këtë njehsor e kanë mbyllur dhe kapakun e tij e kanë pllombuar me pllombë distributive dhe i njëjti njehsor mund të shërbej si provë materiale për gjykatën.

Dëshmitari F...M..., në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 11.01.2024, ka deklaruar se punon si teknik në laborator në KEDS. Tutje, nga prokurori i shtetit i ka prezantuar procesverbalin të datës 01.10.2018 i protokolluar me datë 02.10.2018, dhe ka theksuar se mbetet pranë saj dhe po ashtu ka theksuar se në kohën kur është ekzaminuar njehsori ka qenë teknik i elektro energjetikës.

Dëshmitari I...K..., në shqyrtimin gjyqësor me datë 11.01.2024, ka deklaruar se mbetet pranë të gjeturave të procesverbalit me numër 38/01, të datës 01.10.2018. Tutje, ka shtuar se për çdo rast përpilojnë procesverbal në laborator që bëhet ekzaminimi i njehsorëve, dhe në këtë rast është hapur njehsori dhe është bërë verifikimi i tij.

Dëshmitari E...H..., në shqyrtimin gjyqësor me datë 05.02.2024, ka deklaruar se në rastin në fjalë kanë shkuar së bashku me ekipin në shtëpinë e të pandehurit, të cilët kanë qenë me urdhërese nga eprori për një rast të dyshuar për keqpërdorim të energjisë elektrike, gjatë kontrollit kanë vërejtur se njehsori e ka të dëmtuar ose këputur pllombën shtetërore dhe e kanë dërguar në qendër të kalibrimit për tu vërtetuar nëse ka pasur ndërhyrje. Tutje dëshmitari ka deklaruar se njehsori elektrik ka qenë i vendosur në shtëpinë e të pandehurit, nga një kabull është furnizuar edhe lokali, e cila ishte punëtori për mobile, po ashtu edhe kishte kërkuar që të ndërrohet numri tarifor pasi ka ushtruar veprimtari biznesi. Më tej ka shtuar se i njëjti ka nënshkruar si shfrytëzues në procesverbal me vullnetin e tij të lirë dhe ka theksuar se atë biznes-mobilieri e menaxhon i njëjti. Gjithashtu ka konstatuar se konsumator ka qenë Mexhit Beqiri, por që gjatë kontrollimit, në procesverbal e shkruajnë personin i cili e shfrytëzon atë energji elektrike në atë lokacion.

Provat e administruara:

Gjykata, gjatë shqyrtimit gjyqësor, me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike administroi provat si në vijim: Procesverbali me numër 0724321, i datës 06.07.2018; Foto dokumentacioni me gjithsejtë një (1) faqe dhe katër (4) fotografi; Fatura me numër, i datës 10.10.2018; Procesverbali me numër 38/01, i datës 01.10.2018 dhe Raporti i Kalkulimit, i datës 10.10.2018.

Pas dëgjimit të dëshmitarëve dhe administrimit të provave materiale, i pandehuri nuk ka dhënë mbrojtjen e tij, respektivisht ka shfrytëzuar të drejtën e mbrojtjes në heshtje, ndërsa në deklaratën e dhënë në prokurori me datë 02.10.2019, ndër të tjera kishte theksuar se nuk ka ndërruar asgjë në njehsorin e rrymës, njehsori ka qenë 30 vite, babai i tij e ka shfrytëzuar dhe kur ka vdekur babai i tij, KEDS-si ia ka bartur njehsorin në emrin e tij. Tutje, ka shtuar se rrymën e ka paguar rregullisht dhe ajo shumë prej 3.000 euro është në fakt gjobë kishe për ndërhyrjen e njehsorit, të cilin e kanë dërguar në Kalibro-Prishtinë, dhe pastaj kanë vendosur njehsor të ri, ku përmes atij njehsori e shfrytëzojnë energjinë elektrike në punishten e zdrukthëtarisë dhe për shtëpinë.

Vlerësimi i gjykatës:

Gjykata, pasi ka administruar provat personale dhe materiale, ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv.

Për gjykatën nuk ishte kontestuese fakti se ditën kritike, me datë 06.07.2018 ekipi i KEDS, me urdhëresë nga eprori për një rast të dyshimit, kishin shkuar në shtëpinë ku jetonte i pandehuri Sh...B..., në fshatin K... i M..., për të kontrolluar për mënyrën e përdorimit të energjisë elektrike.

Për gjykatën, nuk ishte kontestuese se me datë 06.07.2018, punëtorët e të dëmtuarës KEDS, gjatë kontrollës kishin vërejtur se shfrytëzuesi, njehsorin nga shtëpia 4/02 e furnizon edhe punëtorinë e mobileve të tij dhe njehsorit i mungon pllomba shtetërore, dhe kjo vërtetohet nga Procesverbali i kësaj kontrole dhe dëgjimi i dëshmitarëve në shqyrtim gjyqësor. Në këtë procesverbal (me numër, i datës 06.07.2018) është konstatuar se ky procesverbal është përpiluar te konsumatori M... B... ndërsa Sh... B..., ishte shfrytëzues i energjisë elektrike. Gjithashtu nuk ishte kontestuese se procesverbalin e kontrollës, e kishte nënshkruar këtu i pandehuri pa vërejtje.

Po ashtu, nuk ishte kontestuese se në shtëpinë e të pandehurit Sh...B..., punëtorët e KEDS-it, për shkak të ekzistimit të dyshimit, e kishin marrë dhe e kishin dërguar njehsorin në Qendrën e Kalibrimit në Prishtinë, dhe kjo vërtetohet edhe nga Procesverbali me numër 38/01, i datës 01.10.2018 dhe dëgjimi i dëshmitareve në shqyrtimin gjyqësor, në të cilin procesverbal është konstatuar se njehsori elektrik i mungon njëra pllombë, kurse dy të tjerat i ka të manipuluar, përkatësisht të hapura dhe prapë të mbyllura.

Gjykata vëren se kontestuese në këtë çështje penale ishte nëse i pandehuri e kishte shfrytëzuar energjinë elektrike duke manipuluar njehsorin apo jo, duke hequr një pllombë dhe dëmtuar dy të tjerat, gjë i pandehuri në fjalën përfundimtare dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, e ka mohuar.

Lidhur me këtë çështje, gjykata pas administrimit të provave një nga një dhe të gjitha së bashku, në kuptim të nenit 7 dhe 360 të KPP-së, ka vërtetuar përtej çdo dyshimi se i pandehuri ka kryer veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata ka vërtetuar se i pandehuri, deri me datë 06.07.2018, kur ekipi i KEDS-it, në fshatin K... i M..., Komuna e Mitrovicës, në shtëpinë e të pandehurit, pa autorizim, ka shfrytëzuar energjinë elektrike ashtu që nga njehsori i tij ka hequr një pllombë dhe i ka dëmtuar dy të tjerat dhe ka hapur njehsorin me të cilin ka manipuluar duke i shkaktuar të dëmtuarës KEDS dëm material.

Këtë gjendje faktike, gjykata e ka vërtetuar nga provat materiale të administruara në shqyrtim gjyqësor, përkatësisht nga Procesverbalet me numër, i datës 06.07.2018 dhe me numër 38/01, i datës 01.10.2018, përmes të cilave është vërtetuar se me urdhëresë të KEDS-it, te konsumatori M... B..., shfrytëzues këtu i pandehuri Sh...B..., në fshatin K... i M... në Mitrovicë, duke shfrytëzuar njehsorin nga shtëpia 4/02, e ka furnizuar edhe punëtorinë e tij në të cilën punon mobile. Nga procesverbali, i datës 06.07.2018, nuk është kontestuese se konsumator i regjistruar, ishte prindi i këtu të pandehurit, ndërsa shfrytëzues ishte pikërisht i pandehuri, i cili edhe kishte nënshkruar pa ndonjë vërejtje këtë procesverbal.

Në këto procesverbale tutje është konstatuar se te konsumatori, njehsori ka qenë pa pllombë shtetërore.

Ndërsa nga procesverbali i datës 01.10.2018, i përpiluar në Qendrën e Kalibrimit i të dëmtuarës, vërtetohet se njehsori elektrik, me numër, të njëjtit i mungon një pllombë kurse dy të tjerat, i ka të manipuluar, të hapura dhe prapë të mbyllura. Gjithashtu sipas këtij procesverbali, vërtetohet se numëruesi i njehsorit është i manipuluar, ka gjurmë të gërvishtjes së numrave në numëror.

Pra nga administrimi i këtyre provave materiale, gjykata ka vërtetuar se i pandehuri, me dashje, në kundërshtim me ligjet në fuqi, ka shfrytëzuar energjinë elektrike duke furnizuar edhe punëtorinë dhe duke mos pasur pllombë në njehsor elektrik, duke i shkaktuar kështu të dëmtuarës KEDS dëm material.

Gjykata i ka besuar në tërësi këtyre provave materiale pasi që procesverbali i datës 06.07.2018 dhe 01.10.2018 është përpiluar nga një organ i autorizuar për distribuim dhe furnizim me energji elektrike në vendin tonë siç është KEDS-i.

Një gjendje të tillë faktike, gjykata e ka vërtetuar edhe nga dëshmia e dëshmitarëve G..R..., F...M..., I...K... të cilët janë teknik laborator në KEDS, të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor, të cilët gjatë ekzaminimit të njehsorit, me numër serik, kanë konstatuar se gjithmonë përpilojnë procesverbal, si të ditës kritike, në të cilën kanë gjetur se njehsorit elektrik në fjalë, i mungon një pllombë, kurse dy të tjerat i ka të manipuluar.

Nga dëshmia e dëshmitarit G..R... të dhënë në shqyrtim kryesor, gjykata ka vërtetuar se i njëjti, si pjesë e ekipit të Qendrës së Kalibrimit, kanë ekzaminuar njehsorin e këtu të pandehurit duke theksuar se mbetet në tërësi pranë gjetjeve si në procesverbalin e datës 01.10.2018, me numër 38/01, e në të cilin procesverbal ishte konstatuar, siç u sqarua edhe më lartë, se njehsorit i mungonte një pllombë ndërsa dy të tjerat i kishte të manipuluar. Gjithashtu nga dëshmia e këtij dëshmitari, gjykata ka vërtetuar faktin se të njëjtit nuk merren me atë se kush dhe kur ka ndërhyrë në njehsor elektrik, por vetëm me të gjeturat që kanë të bëjnë me parregullsitë apo ndërhyrjet në njehsor.

Gjithashtu, edhe nga dëshmia e dy dëshmitarëve tjerë të cilët kanë qenë pjesë e ekipit të Qendrës së Kalibrimit, F...M... dhe I...K..., kanë konfirmuar se kanë ekzaminuar njehsorin e të pandehurit dhe kanë mbetur në tërësi pranë të gjeturave si në procesverbal.

Gjykata ka iu ka falur besimin në tërësi dëshmisë së këtyre dëshmitarëve pasi që dëshmitë e tyre, janë në përputhje me provat tjera materiale dhe personale, përkatësisht me provat materiale siç janë procesverbali i përpiluar në Qendrën e Kalibrimit, i datës 01.10.2018 por në përputhje edhe me deklaratën e dëshmitarit E...H... dhe foto dokumentacionin që gjendet në lëndë.

Ndërsa nga deklarata e dëshmitarit E...H..., të dhënë në shqyrtim gjyqësor, gjykata e ka vërtetuar faktin se i njëjti ka qenë në vendin e ngjarjes nga ana e ekipit të KEDS-it, dhe gjatë kontrollit kanë vërejtur se njehsori e ka të dëmtuar ose këputur pllombën shtetërore dhe e kanë dërguar në qendër të kalibrimit për tu vërtetuar nëse ka pasur ndërhyrje, gjithashtu edhe një kabull e cila ka furnizuar edhe lokalin e cila ishte punëtori për mobile, e cila kabull ishte e vendosur nga shtëpia e të pandehurit, në punëtorinë e tij. Nga dëshmia e këtij dëshmitari, gjykata ka vërtetuar se konsumator është personi në emrin e të cilit është e regjistruar një orë përkatësisht njehsor, ndërsa në të gjitha rastet kur konsumatori i regjistruar, për çfarëdo arsye nuk gjendet në adresë (p.sh. nëse ka ndërruar jetë), ata e shkruajnë emrin e personit që është shfrytëzues i energjisë elektrike. Ky dëshmitar, gjithashtu ka vërtetuar faktin se i pandehuri ka qenë shfrytëzues i energjisë elektrike dhe këtë e kanë konfirmuar me rastin e përpilimit të procesverbalit të kontrollës kur edhe kanë marrë të dhënat personale të tij dhe sipas dëshmitarit, ishte pikërisht i pandehuri që iu kishte treguar se ai menaxhon me atë mobilieri përkatësisht biznes. Përfundimisht, ky dëshmitar ka konfirmuar faktin se lokali i të pandehurit ishte i lidhur përmes një kabllo dhe një pjesë e energjisë së shfrytëzuar, nuk është regjistruar.

Gjykata ia ka falur në tërësi besimin dëshmisë së këtij dëshmitari, kjo për arsye sepse ishte e qartë dhe në harmoni të plotë me provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe të administruara e të përmendura më lartë. Faktet të cilat i ka përmendur dëshmitari, janë në harmoni të plotë me procesverbalin e kontrollës i datës 06.07.2018 si dhe procesverbali i Qendrës së Kalibrimit i të dëmtuarës, i datës 01.10.2018, por edhe me foto dokumentacionin që gjendet në lëndë.

Nga administrimi i provave materiale siç janë kalkulimi i rikthimit të humbjeve i të dëmtuarës, i datës 10.10.2018 dhe Fatura me numër, e datës 10.10.2018, vërtetohet dëmi i shkaktuar të dëmtuarës, i cili kalkulim është bërë në bazë të makinerisë e cila është gjendur në punëtorinë

e të pandehurit, e cila makineri konstatohet edhe në procesverbalin e kontrollës të datës 06.07.2018.

Gjykata, e vlerësoi edhe deklaratën e të pandehurit të dhënë në prokurori, i cili ka theksuar se nuk ka ndërruar asgjë në njehsorin e rrymës, këtë deklaram të tij e vlerësoi si tendencë të pandehurit për t'i ikur përgjegjësisë penale. Kjo ngase deklarimi i tij nuk gjente mbështetje në asnjë provë materiale. Për më tepër, i pandehuri në deklaratën e tij të dhënë në prokurori e pranon faktin se njehsorin e shfrytëzojnë në punishten e zdrukthëtarisë dhe shtëpisë, se është pagues i rregullt i shërbimit të energjisë elektrike.

Neni 314 paragrafi 1 i KPRK-së ka përcaktuar se: *“1. Kushdo që me anë të lajthimit, largimit ose mënyrave tjera siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.”*

Sa i përket elementeve të përgjithshme të veprës penale, nga provat e administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, është vërtetuar përtej çdo dyshimi se i akuzuari, duke shfrytëzuar energjinë elektrike, duke manipuluar njehsorin, pra pa kompensim ndaj institucionit të autorizuar për mbledhjen e këtyre mjeteve në emër të shpenzimit të energjisë elektrike, i ka shkaktuar dëm material të dëmtuarës KEDS.

Gjykata ka vërtetuar elementin subjektiv të kësaj vepre penale, përkatësisht dashjen e të pandehurit për kryerjen e kësaj vepre penale ashtu që i njëjti, duke shfrytëzuar energjinë elektrike përkatësisht duke manipuluar në njehsor elektrik, ka shfrytëzuar pa autorizim energjinë elektrike dhe në këtë mënyrë i është shmangur pagesës së detyrimeve për energjinë elektrike të shfrytëzuar dhe i ka shkaktuar dëm material të dëmtuarës KEDS. Andaj për këtë gjykatë, përtej çdo dyshimi, pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor, është vërtetuar se i pandehuri me veprimet e tij, ka kryer veprën penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Rrethana rëndësuese në këtë çështje penale gjykata nuk ka gjetur, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e ka vlerësuar sjelljen përgjithësisht korrekte të pandehurit, rrethanat familjare përkatësisht faktin se i njëjti është person familjar.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se shqiptimi i dënimit me gjobë ndaj të pandehurit, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë të të pandehurit. Po ashtu, Gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahet nga çfarëdo veprimi që është i dëmshëm për shoqërinë në përgjithësi.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449, 450 dhe 452 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor, ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit nr.08\L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për obligimin e të pandehurit për t'ia kompensuar dëmin material kompanisë KEDS, gjykata e ka bazuar në nenin 462 të KPP-së, pasi që nga të dhënat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka vlerësuar se ka bazë të sigurt për detyrimin e të pandehurit për kompensimin e dëmit material.

Andaj gjykata duke u bazuar me nenin.359, 360, 364, 449, 450, 452 dhe 462 të KPP-së, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.496/2019, datë 07.03.2024

Procesmbajtësja
Doruntina BEKA

Gjyqtari
Xhemajl JUSUFI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të Aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët kundërshtare.